



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 24.05.2018, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e financimit prej 23 milionë eurosh për projektin e burimeve ujore dhe ujitjes, si dhe ratifikimi i ndryshimit të marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit të burimeve ujore dhe ujitjes".

(ardhur me procedurë të përshpejtuar) (*Komision për dhenie mendimi*)

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Rakip Suli, Tatjana Nurçe, Ilir Ndraxhi, Robert Bitri, Dritan Bici, Edmond Leka dhe Fadil Nasufi.

Mungojnë:

Florjon Mima, Endri Hasa, Lorenc Luka, Izmira Ulqinaku, Hekuran Hoxhalli, Gjetan Gjetani, Agron Çela dhe Lifter Koka.

Të ftuar:

Irfan Tarelli – përfaqësues i Ministrisë së Bujqesisë

Etleva Pengili – përfaqësues i Ministrisë së Bujqesisë

Tedi Alushi – përfaqësues i Ministrisë së Bujqesisë

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi – Përsëndetje, të nderuar kolegë deputetë!

Vijojmë me axhendën që kemi parashikuar për sot, shqyrtimin e projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e financimit prej 23 milionë eurosh për projektin e burimeve ujore dhe ujitjes, si dhe ratifikimi i ndryshimit të marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit të burimeve ujore dhe ujitjes", ardhur në Kuvend me procedurë të përshpejtuar. Relator është Besnik Baraj.

Të ftuar janë Irfan Tarelli, Etleva Pengili dhe Tedi Alushi. Mirë se erdhët në komision!

Fjala për ju zoti Tarelli. Shkurtimisht një prezantim të projektligjit.

Irfan Tarelli - Faleminderit, zoti kryetar!

Projektligji synon ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e financimit për projektin e burimeve ujore dhe të ujitjes, me një hua në shumën 23 milionë eurosh, si dhe ratifikimin e ndryshimit të marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit të burimeve ujore dhe ujitjes.

Marrëveshja fillestare është miratuar në vitin 2013 dhe me anë të saj synohej financimi i projektit të përbashkët të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Bankës Botërore, për burimet ujore dhe ujitjen me qëllim përmirësimin e performancës së sistemeve të ujitjes në zonën që mbulonte ky projekt. Projekti kishte një kosto prej 45 milionë USD dhe me anë të kësaj huaje mbulohej pjesa prej 31 milionë eurosh (ose 40 milionë USD). Qeveria suedeze do të kontribuonte me 5 milionë USD, ndërsa TVSH-ja dhe kostot lokale mbulohen nga qeveria shqiptare. Projekti i burimeve ujore dhe ujitjes përcakton kuadrin strategjik për menaxhimin e burimeve ujore në plan kombëtar dhe në basenet Drin – Bunë dhe Seman. Menaxhimi i integruar i burimeve ujore është një prej objektivave që synon të përmbushë projekti. Objektivi tjetër lidhet me përmirësimin e ofrimit të shërbimeve të ujitjes në sistemet e përzgjedhura të ujitjes për këtë projekt.

Pra projektligji synon të rregullojë dy çështje që janë 1) financimi shtesë prej 23 milionë eurosh po për projektlin e burimeve ujore dhe ujitjes; dhe 2) ndryshimin e huasë së vitit 2013 për shkak të kësaj shtese financimi. Financimi shtesë prej 23 milionë eurosh që sigurohet me anë të marrëveshjes së re të lidhur me IBRD-në do të mbështesë aktivitetet në komponentët: Rehabilitimi i digave dhe i sistemeve të ujitjes dhe kullimit me synim përmirësimin e performancës së organizatave që ofrojnë shërbimet e ujitjes; Mbështetje institucionale për ujitjen dhe kullimin me synim rehabilitimin dhe modernizimin e sistemeve të ujitjes e kullimit dhe infrastrukturës së digave; Mbështetje për zbatimin e projektit me synim menaxhimin e burimeve të projektit në përputhje me objektivat dhe procedurat e tij. Qeveria shqiptare do të japë kontributin e saj për TVSH-në dhe kosto lokale, në shumën prej 4.6 milionë euro.

Ndryshimi i marrëveshjes ekzistuese të huas konsiston në tre elementë që janë: Ndryshime në tabelën e kostove të cilat mundësojnë kalimin e kursimeve që rezultojnë nga disa aktivitete të përfunduara të projektit në zërin e investimeve, me qëllim rritjen e sipërfaqes ujitëse të rehabilituar; Ndryshimi i objektivit të zhvillimit të projektit me qëllim harmonizimin e tij me atë të financimit shtesë, në mënyrë që të dyja financimet, që do të realizohen në të njëjtën periudhë kohore, të kenë të njëjtin objektiv në përputhje me gjendjen dhe treguesit aktualë; Ndryshimi që lidhet me rregullimin e emërimit të agjencisë zbatuese, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU) në Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR).

Ju falemnderit!

Eduard Shalsi – Atëherë, zoti Baraj kemi ndonjë gjë për të shtuar?

Besnik Baraj – Nuk kam. Unë ftoj kolegët të votojmë marrëveshjen.

Eduard Shalsi – Ka ndonjë pyetje? Koment?

Jo. Vazhdojmë atëherë me votimin në parim të projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e financimit prej 23 milionë eurosh për projektin e burimeve ujore dhe ujitjes, si dhe ratifikimi i ndryshimit të marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit të burimeve ujore dhe ujitjes". Jemi në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, e hedhim në votim në parim. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Neni 1.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Neni 2.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Kush është pro në tërësi? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Duke ju falënderuar dhe uruar punë të mbarë, së bashku, kolegë, do të shihemi javën e ardhshme!

MBYLLET MBLEDHJA